GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Buletini Informativ

Korrik — Dhjetor 2017

PËRMBAJTJA:

RAPORTI GJASHTËMUJOR I PUNËS 2

VIZITAT DHE AKTIVITETET E GJYKATËS.....4

PËRVOJAT DHE PRAKTIKAT PERSONALE.....7

GJEDNJ - VENDIME TË RËNDËSISHME 8

KOMISIONI I VENECIAS - NGJARJE ME RËNDËSI.....11

AKTGJYKIMET 12

Kushtetuta e Kosovës - Kapitulli VIII

Gjykata Kushtetuese
Neni 112

[Parimet e Përgjithshme]

Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe të përputhshmërisë së ligjeve me Kushtetutën.

Gjykata Kushtetuese është plotësisht e pavarur në kryerjen e përgjegjësive të saj.

Përbërja e Gjykatës Kushtetuese

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës përbëhet nga 9 (nëntë) gjyqtarë.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës emërohen në pajtim me nenin 114 [*Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, dhe të neneve 6 dhe 7 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Pas themelimit të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2009 dhe në pajtim me nenin e mëparshëm 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 6 (gjashtë) nga 9 (nëntë) gjyqtarët u emëruan nga Presidenti i Republikës së Kosovës me propozimin e Kuvendit.

Nga 6 (gjashtë) gjyqtarët vendorë, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat 3 (tre) vjeçar, pa mundësi të rizgjedhjes, 2 (dy) gjyqtarë shërbyen për një mandat prej 6 (gjashtë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes, dhe 2 (dy) gjyqtarë shërbejnë për një mandat prej 9 (nëntë) vjetësh, pa mundësi të rizgjedhjes.

Në pajtim me nenin e lartpërmendur 152 [*Përbërja e Përkohshme e Gjykatës Kushtetuese*] të Kushtetutës, 3 (tre) gjyqtarë ndërkombëtarë u emëruan nga Përfaqësuesi Ndërkombëtar Civil, pas konsultimit me Kryetarin e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Aktualisht, Gjykata Kushtetuese përbëhet nga 8 (tetë) gjyqtarë: 6 (gjashtë) gjyqtarë vendorë dhe 2 (dy) gjyqtarë ndërkombëtarë.

Statusi i lëndëve

Gjatë periudhës gjashtëmujore: 1 korrik – 31 dhjetor 2017, Gjykata ka pasur në punë gjithsej 163 kërkesa/ lëndë.

Gjithsej 85 kërkesa janë zgjidhur ose 52.1% e të gjitha rasteve në disponim.

Gjatë kësaj periudhe, 85 vendime janë publikuar në ueb-faqen e Gjykatës dhe janë proceduar tek palët.

Dinamika e kërkesave të pranuara sipas muajve (1 korrik – 31 dhjetor 2017)



Në vijim janë paraqitur 9 aktgjykimet që Gjykata nxori gjatë periudhës gjashtëmujore, 1 korrik – 31 dhjetor 2017:

- Aktgjykim në rastin KI 90/16, parashtruar nga: Branislav Jokić. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës, KKPK/D/R/230/2014, të 13 marsit 2014.
- Aktgjykim në rastin KI 138/15, parashtruar nga: "Sharr Beteiligungs GmbH" SH.P.K.. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 116/2015, të 17 qershorit 2015.
- Aktgjykim në rastin KI 10/17, parashtruar nga: Sadije Shabani. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së mospërmbarimit të vendimit të Komisionit të Ankesave të Shërbyesve Civilë të Komunës së Skenderajt, nr. 112 -158/1, të 12 qershorit 2008.
- Aktgjykim në rastin KI 93/16, parashtruar nga: Maliq Maliqi dhe Skender Maliqi. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. nr. 321/2012, të 13 nëntorit 2013.
- Aktgjykim në rastin KI 104/16, parashtruar nga: Miodrag Pavić. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML-KZZ. nr. 110/2016, të 16 majit 2016.
- Aktgjykim në rastin KI 33/16, parashtruar nga: Minire Zeka. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës së Apelit të Republikës së Kosovës, AC. nr. 4276/2014, të 9 qershorit 2015.
- Aktgjykim në rastin KI 142/16, parashtruar nga: Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së neneve 10 dhe 40.1.5 të Shtojcës së Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.
- Aktgjykim në rastin KI 55/17, parashtruar nga: Tonka Berisha. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së Vendimit KGJ nr. 13/2017, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të 13 janarit 2017.
- Aktgjykim në rastin KI 81/16, parashtruar nga: Valdet Nikçi. Në kërkesën e parashtruar u kërkua vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 949/16, të 20 prillit 2016.

Llojet e shkeljeve të pretenduara

Llojet e shkeljeve të pretenduara nga 84 kërkesat e pranuara gjatë periudhës gjashtëmujore, 1 korrik – 31 janar 2017, janë si në vijim:

- Neni 21 [Parimet e përgjithshme], 6 raste ose 7,1%;
- Neni 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare], 7 raste ose 8,3%;
- Neni 24 [Barazia para ligjit], 10 raste ose 11,9 %;
- Neni 31 [E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm], 34 raste ose 40,5%;
- Neni 45 [Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes], 3 raste ose 3,6%;
- Neni 46 [Mbrojtja e pronës], 14 raste, ose 16,7%;
- Neni 47 [E drejta për arsimin], 1 rast ose 1,2%;
- Neni 49 [E drejta e punës dhe ushtrimit të profesionit], 4 raste ose 4,8%;

- Shqyrtimi kushtetues i vendimeve të gjyqësorit, 1 rast ose 1,2%
- Shkelje të tjera 4 raste, ose 4,8%

Shkeljet e pretenduara, sipas llojit të shkeljeve
(1 korrik – 31 dhjetor 2017)



Autorët e supozuar të shkeljes së të drejtave

- 81 ose 96,4 % kërkesa kanë të bëjnë me vendimet e gjyqësorit
- 3 ose 3,6 % kërkesa kanë të bëjnë me autoritetet e tjera publike

Shkelësit e supozuar të të drejtave
(1 korrik – 31 dhjetor 2017)



Qasja në Gjykatë

Qasja e individëve në Gjykatë është si në vijim:

- 70 kërkesa të parashtruara nga shqiptarët, ose 83,3%
- 3 kërkesa të parashtruara nga serbët, ose 3,6%
- 2 kërkesa të parashtruara nga komuniteti turk, ose 2,4%
- 1 kërkesë e parashtruar nga tjerët, ose 1,2%
- 8 kërkesa të parashtruara nga autoritetet e tjera publike (personat juridik), ose 9,5%

Struktura etnike e paraqitësve të kërkesave
(1 korrik – 31 dhjetor 2017)



Seancat dhe kolegjet shqyrtuese

Gjatë periudhës gjashtëmujore: 1 korrik – 31 dhjetor 2017, Gjykata Kushtetuese ka mbajtur 17 seanca plenare me 79 kolegje shqyrtuese, në të cilat, rastet e shqyrtuara u zgjidhën me vendime, me aktvendime dhe me aktgjykime. Nga 1 korriku deri më 31 dhjetor 2017, Gjykata Kushtetuese ka publikuar gjithsej 85 vendime.

Struktura e vendimeve të publikuara është si në vijim:

- 9 Aktgjykime (10,6%)
- 71 Aktvendime për papranueshmëri (83,5%)
- 4 Vendime për refuzim të kërkesës me procedurë të shkurtër (4,7%)
- 1 Vendim për hedhje poshtë të kërkesës (1,2%)



14 korrik 2017

Gjyqtarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Gresa Caka-Nimani, mori pjesë në Konferencën e 5-të të Forumit Botëror të Drejtësisë, i cili u mbajt në Hagë të Holandës, më 10-13 korrik 2017.

Krahas pjesëmarrjes në konferencën treditore me karakter ndërkombëtar, gjyqtarja Caka-Nimani, mori pjesë edhe në diskutimin e mbajtur në panel në temën "*Kushtetutbërja në shoqëritë pas konflikteve*", që u moderua nga z. Tom Ginsburg, profesor i së drejtës ndërkombëtare dhe i shkencave politike në Universitetin e Çikagos, dhe njëherësh anëtar i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të SHBA-së.

Në diskutimin e zhvilluar përkitazi me konceptet dhe trendët aktual përkitazi me proceset e kushtetutbërjes në shoqëritë pas konflikteve, gjyqtarja Caka-Nimani, ndër të tjera, prezantoi para akademikëve të së drejtës kushtetuese përparësitë dhe dobësitë e procesit të ndërkombëtarizuar të kushtetutbërjes në Republikën e Kosovës.

25 korrik 2017

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, priti në takim lamtumirës ambasadorin e Republikës së Sllovenisë në Prishtinë, z. Miljan Majhen. Gjatë bashkëbisedimit, kryetarja Rama-Hajrizi e falënderoi ambasadorin Majhen për bashkëpunimin e deritanishëm dhe për kontributin e dhënë në thellimin e marrëdhënieve reciproke ndërmjet dy vendeve.

Ajo vlerësoi lart përkrahjen që ka ofruar Republika e Sllovenisë në forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë, në konsolidimin e institucioneve të drejtësisë, si dhe në anëtarësimin e vendit tonë në organizatat e ndryshme ndërkombëtare.

Kryetarja Rama-Hajrizi në vijim vuri theksin edhe në marrëdhëniet e bashkëpunimit të shkëlqyer me Gjykatën Kushtetuese të Sllovenisë, duke shprehur bindjen se ato do të intensifikohen edhe më tej nëpërmjet realizimit të projekteve të përbashkëta dhe shkëmbimit të ndërsjellë të përvojave. Ambasadori Majhen vlerësoi se Kosova duhet të vazhdojë përpjekjet e saj për ndërtimin e një shoqërie demokratike dhe u shpreh i sigurt se bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet dy shteteve, si dhe i gjykatave kushtetuese të të dyja vendeve, do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

15 shtator 2017

Me ftesë të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Lituanisë dhe të Komisionit të Venecias, kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, zëvendëskryetari i Gjykatës, z. Ivan Çukaloviq, dhe gjyqtarja, znj. Gresa Caka-Nimani, qëndruan në kryeqytetin lituanez Vilnius, më 11-14 shtator 2017.

Delegacioni i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës qëndroi në Vilnius me ftesën për të marrë pjesë në Kongresin e 4-të të Konferencës Botërore të Drejtësisë Kushtetuese, i cili këtë vit mblodhi kryetarë e gjyqtarë të gjykatave kushtetuese dhe të gjykatave supreme nga 90 shtete të botës.

Kongresi i 4-të u organizua në temën: *"Sundimi i ligjit dhe drejtësia kushtetuese në botën moderne"*, me ç'rast pjesëmarrësit patën mundësinë që të diskutojnë dhe të shkëmbejnë pikëpamjet e tyre profesionale rreth sfidave me të cilat vazhdon të përballet sundimi i ligjit dhe drejtësia kushtetuese në vendet e tyre të

origjinës. Gjatë qëndrimit në Vilnius, kryetarja Rama-Hajrizi zhvilloi takime të ndara edhe me kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Lituanisë, z. Dainius Zalimas, si dhe me kryetarin e Komisionit të Venecias, z. Gianni Buquicchio.
Gjykata Kushtetuese e Kosovës është anëtarësuar në Konferencën Botërore të Drejtësisë Kushtetuese, më 17 shtator 2014.

15 shtator 2017

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës dhe Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë, organizuan punëtorinë në temën: "*Komunikimi në kohë krizash: GJEDNJ dhe praktikat e saj më të mira*", e cila u mbajt në "Villa Gërmia" në Prishtinë.

Mysafire speciale dhe njëherësh moderatore e punëtorisë ishte Zyrtarja e lartë për Informim në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), me seli në Strasburg, znj. Tracy Turner-Trenz. Gjatë prezantimit të mbajtur përballë gjyqtarëve, këshilltarëve juridikë dhe zyrtarëve të tjerë të Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, znj. Turner-Trenz fillimisht bëri një përshkrim të shkurtër përkitazi me punën, rolin dhe funksionin që kryen Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në vazhdim ajo prezantoi detaje më të hollësishme rreth përgjegjësisë që ka dhe punës që kryen Zyra për Media në kuadër të GJEDNJ-së, duke ofruar shembuj praktikë të komunikimit të çdoditshëm me publikun dhe me mediat e ndryshme anembanë Evropës.

Vëmendje të posaçme, znj. Turner-Trenz, i kushtojë komunikimit të GJEDNJ-së me mediat në kohë krizash, duke veçuar për pjesëmarrësit në punëtori disa raste konkrete me të cilat ajo është ballafaquar dhe duke dhënë sqarime të hollësishme se kur dhe si, kjo gjykatë ndërkombëtare dhe Zyra e saj për Media, kanë reaguar ndaj sfidave të paraqitura.

5 tetor 2017

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës dhe me përkrahjen e Fondacionit gjerman për bashkëpunim ligjor ndërkombëtar (IRZ), organizuan punëtorinë në temën: "*E drejta për vendim të arsyetuar – Elementet dhe kërkesat kryesore të saj/ Jurisprudenca, pikëpamjet dhe perspektivat e Gjykatës Supreme dhe të Gjykatës Kushtetuese*", e cila u mbajt në Selanik.

Në punëtori morën pjesë gjyqtarë dhe këshilltarë juridikë nga të dy gjykatat, të cilët ndërmjet tjerash diskutuan dhe shkëmbyen pikëpamjet e tyre përkitazi me parimet e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm, për vendimmarrjen brenda afatit të arsyeshëm, si dhe për zbatimin e dispozitave të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), e në veçanti të nenit 6 të kësaj Konvente. Temë e diskutimit ishte edhe ndikimi i aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) në legjislacionin dhe në praktikën gjyqësore të Kosovës.

Ndër folësit kryesorë në punëtori ishin edhe ish-kryetari i Gjykatës Federale Administrative në Leipzig, Dr. Otto Mallmann, si dhe Prof. dr. Michaela Wittinger, profesoreshë e të Drejtës kushtetuese dhe e të Drejtës evropiane në Universitetin Federal të Shkencave të Aplikuara Administrative në Brühl të Gjermanisë, të cilët gjatë prezantimit të tyre ofruan një pasqyrë të përgjithshme rreth praktikës gjyqësore gjermane për të drejtën për vendim të arsyetuar dhe zbatimit të nenit 6 të KEDNJ-së.

25 tetor 2017

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, kremtoi Vitin e 8-të Gjyqësor me një ceremoni solemne, që u mbajtë në sallën "Dyar" të hotelit "Swiss Diamond Hotel" në Prishtinë. Në ceremoni morën pjesë udhëheqësit më të lartë shtetërorë, përfaqësues të akredituar të misioneve diplomatike dhe të organizatave ndërkombëtare në vend, si dhe delegacionet e nivelit më të lartë nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë, nga Gjykata

Kushtetuese e Malit të Zi, nga Gjykata Kushtetuese e Maqedonisë, nga Gjykata Kushtetuese e Bullgarisë, nga Gjykata Kushtetuese e Turqisë si dhe Gjykata e Lartë e Shqipërisë.

Me fjalim rasti, pjesëmarrësve në këtë ceremoni iu drejtuan kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, znj. Arta Rama-Hajrizi, presidenti i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Kadri Veseli, kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Ramush Haradinaj, si dhe ish-kryetarja e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kroacisë, znj. Jasna Omejec.

20 dhjetor 2017

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Akademinë e Drejtësisë së Republikës së Kosovës organizuan punëtorinë e përbashkët në temën: "*Roli dhe kompetencat e Gjykatës Kushtetuese. Raporti me gjykatat e rregullta dhe institucionet tjera. Kërkesat sipas Nenit 113.7 dhe Nenit 113.8 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës*", e cila u mbajt në Gjykatoren e Gjykatës Kushtetuese.

Punëtoria pati për qëllim njoftimin e gjyqtarëve të rinj të gjykatave të rregullta në Republikën e Kosovës, me rolin dhe me kompetencat që ka Gjykata Kushtetuese në raport me gjyqësorin e rregullt, si dhe me nivelet e tjera të pushtetit, për të cilat ata u njoftuan më për së afërmi nga këshilltari i parë juridik i Gjykatës, z. Sevdail Kastrati, dhe këshilltarja juridike, znj. Arbana Beqiri-Plakolli.

Gjatë punëtorisë së mbajtur, këshilltarët juridikë Kastrati dhe Beqiri-Plakolli i njoftuan gjyqtarët e rinj më hollësisht edhe me procesin e punës në Gjykatën Kushtetuese, me pranimin dhe me procedimin e kërkesave të parashtruara nga palët, me kriteret e pranueshmërisë së kërkesave të parashtruara, si dhe me procesin e marrjes së vendimeve nga gjyqtarët.

Në fokus të prezantimit të tyre ishte në veçanti shqyrtimi i vendimeve të autoriteteve publike në raport me Kapitullin II të Kushtetutës nga Gjykata Kushtetuese, si dhe shqyrtimi i akteve të kontestuara në raport me Kushtetutën nga gjykatat e rregullta.

Një prezantim të shkurtër mbi marrëdhëniet e Gjykatës Kushtetuese me Komisionin e Venecias, pranimin e kërkesave me pyetje të gjykatave kushtetuese dhe të gjykatave supreme të shteteve anëtare nëpërmjet Forumit të Komisionit të Venecias, si dhe parashtrimin e kërkesave nga Gjykata në këtë forum, e bëri edhe z. Veton Dula, drejtor i Zyrës për Komunikim dhe Informim dhe njëherësh Zyrtar Ndërlidhës i Gjykatës Kushtetuese me Komisionin e Venecias.

Nexhat Kelmendi

Programi i praktikës në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Strasburg

Ishte nder dhe privilegji im që të marrë pjesë në programin e vizitave 5-mujore studimore në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg, si pjesë e projektit të financuar nga Qeveria e Zvicrës dhe mbështetur nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë.

Me ardhjen time në Gjykatë, unë u caktova në Divizionin e Katërmbëdhjetë, i cili përbëhej nga vendet e Ballkanit Perëndimor, ku kam punuar nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë të z. Peter Kempees, Udhëheqës i Divizionit, z. Ylli Peço, avokat kryesor për rastet kundër Shqipërisë dhe me znj. Erinda Meli, avokate e caktuar në rastet kundër Shqipërisë.

Para se të filloj të punoj në rastet aktuale, kam ndjekur trajnimet e nevojshme lidhur me përdorimin e sistemit të menaxhimit të lëndëve. Megjithëse në shikim të parë kjo mund të duket të jetë një përvojë e një natyre mjaft teknike, është një mjet shumë i rëndësishëm për të kuptuar organizimin dhe strukturën e GJEDNJ – së në aspektin e sistemit të menaxhimit të rasteve, i cili ofron mundësi të pakufizuara për punën kërkimore në çështje shumë specifike.

Pas përfundimit të trajnimeve të mia të planifikuara, fillova të punoja me rastet e WECL (praktika gjyqësore e mirë-vendosur) dhe kërkesat kundër Shqipërisë nën mbikëqyrjen e z. Ylli Peço. Këto raste kryesisht përf-shinin çështje të natyrës civilo-pronësore, ndërsa kërkesat kryesisht kishin të bënin me pretendimet për shkelje të nenit 6, në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1 të Konventës.

Në një fazë të mëvonshme, unë u caktova gjithashtu të merrem me rastet e natyrës penale që kryesisht kishin të bënin me shkeljet e pretenduara të nenit 3 (Ndalimi i torturës), neni 5 (E drejta për liri dhe siguri) dhe neni 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës. Përveç punës sime me rastet aktuale, kam kontribuar shumë shpesh në përkthimin e rregulloreve specifike të Gjykatës nga gjuha angleze në gjuhën shqipe. Një përvojë shumë interesante dhe e vlefshme profesionalisht ishte edhe pjesëmarrja ime në mbledhjet e gjyqtarëve të GJEDNJ-së, ku u diskutuan çështjet e Dhomës së Madhe dhe seancat e shpeshta të trajnimit të organizuara nga Gjykata dhe Këshilli i Evropës.

Mësimet e nxjerra

Përvoja e fituar nga vizita ime studimore në GJEDNJ ka përmbushur pritjet e mia dhe pa dyshim më ka ndihmuar të thellojë më shumë njohuritë e mia profesionale për të drejtat e njeriut. Rëndësia dhe vlera e këtij projekti janë edhe më të mëdha kur merret parasysh natyra e punës dhe detyrimi i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për të aplikuar praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së në raste individuale (ankesat individuale).

Kam kuptuar gjithashtu se vetëm kur të njihni praktikisht punën e GJEDNJ-së, ju mund të kuptoni se pse kaq shumë vende sovrane, duke u mbështetur vetëm në vullnetin e tyre të lirë, kanë ratifikuar Konventën dhe pse Gjykata ka arritur të shtrijë ndikimin e saj edhe në ato vende që nuk janë të detyruara me Konventë. Një shembull i tillë është edhe vendi nga ku unë kam ardhur - Republika e Kosovës.

Në nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] Kushtetuta e Republikës së Kosovës parasheh që: *"Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë do të interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut"*.

Ky formulim i nenit 53 të Kushtetutës ka bërë zbatimin e jurisprudencës së GJEDNJ-së një detyrim kushtetues për të gjitha gjykatat e Kosovës. Prandaj, besoj që kjo pasqyron mjaft qartë rëndësinë e kësaj vizite studimore për mua dhe për kolegët e tjerë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës të cilët ishin pjesë e të njëjtit projekt.

Në fund, do të doja të shfrytëzoj këtë mundësi për të shprehur mirënjohjen time të sinqertë për ish-Kryetarin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, z. Enver Hasani, Kryetaren aktuale të Gjykatës, znj. Arta Rama-Hajrizi, të gjithë gjyqtarët e Gjykatës, Qeverinë Zvicerane dhe Zyrën e Këshillit të Evropës në Prishtinë, për ta bërë këtë projekt të mundshëm. Dëshiroj gjithashtu të falënderoj për mbështetjen e tyre të mirëpritur dhe të vazhdueshme z. Michael Wischuf, Zëvendës Sekretar, Znj. Audrey Gabilly, Koordinatore për Trajnime, si dhe të gjithë ata me të cilët kam punuar çdo ditë në GJEDNJ: z. Peter Kempees, z. Ylli Peço, znj. Erinda Meli dhe të gjithë stafin e Divizionit 14.

GJEDNJ – Vendime të rëndësishme (1 janar – 30 qershor 2017)

* Ndalimi i mbulimit të fytyrës në publik në Belgjik nuk shkel të drejtat e Konventës (11/07/2017)

Në aktgjykimin e saj në rastin ***Belcacemi dhe Oussar kundër Belgjikës*** (aplikimi nr. 37798/13), Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut arriti njëzëri në përfundimin se: **nuk ka pasur shkelje të neneve 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare) dhe 9 (liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë)** e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, **dhe nuk ka pasur shkelje të nenit 14 (ndalimi i diskriminimit)**, të lidhur me nenet 8 dhe 9.
Rasti kishte të bënte me ndalimin në publik të veshjes që mbulon pjesërisht apo plotësisht fytyrën, sipas ligjit të 1 qershorit 2011 të Belgjikës. Gjykata gjeti në veçanti se kufizimi kërkonte të garantonte kushtet e "jetesës së përbashkët" dhe "mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve" dhe se ishte i "nevojshëm në një shoqëri demokratike". Së pari, siç kishte ndodhur në rastin "S.A.S. kundër Francës", Gjykata gjeti se shqetësimi për sigurimin e respektit për garancitë minimale për jetën në shoqëri mund të shiheshin si element i "mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të të tjerëve" dhe që kjo ndalesë, në parim, ishte e justifikueshme vetëm në shkallën në të cilën ajo kërkonte të garantonte kushtet për "jetën e përbashkët". Në këtë kuptim, Gjykata shpjegoi se, përmes kontakteve të drejtpërdrejta dhe të vazhdueshme me palët e interesuara në vendin e tyre, autoritetet shtetërore në parim ishin në pozitë më të mirë sesa një gjykatë ndërkombëtare për të vlerësuar nevojat dhe kontekstin lokal. Për këtë arsye, gjatë miratimit të dispozitave në fjalë, shteti i Belgjikës kishte kërkuar t'i përgjigjej një praktike që konsiderohet, në shoqërinë belge, si e papërputhshme me komunikimin shoqëror dhe, në shkallë më të përgjithshme, me krijimin e marrëdhënieve njerëzore, të cilat ishin thelbësore për jetesën në shoqëri. Kjo ishte një çështje e mbrojtjes së gjendjes së ndërveprimit midis individëve e cila, për shtetin, ishte thelbësore për të siguruar funksionimin e një shoqërie demokratike. Çështja nëse shamia që mbulon gjithë fytyrën duhej të pranohej në sferën publike të Belgjikës ishte, në këtë mënyrë, një zgjidhje e shoqërisë.
Së dyti, lidhur me proporcionalitetin e kufizimit, Gjykata vuri re se sanksioni për mosrespektimin e kufizimit sipas ligjit të Belgjikës mund të varionte nga gjoba e deri te dënimi me burg. Megjithatë, dënimi me burg rezervohej për ata që bënin kundërvajtje të vazhdueshme dhe nuk aplikohej automatikisht. Krahas kësaj, kundërvajtja klasifikohej si "hibride" sipas ligjit të Belgjikës, pjesërisht në pajtim me të drejtën penale dhe pjesërisht me atë administrative. Në këtë mënyrë, në kontekstin e veprimit administrativ, masa alternative ishin të mundshme dhe merreshin praktikisht në nivelin e komunës.

* Vendimi për të kufizuar komunikimin midis avokatit dhe të të akuzuarit mbi bazën e mbrojtjes së sekreteve shtetërore binte ndesh me Konventën (25/07/2017)

Rasti ***M kundër Holandës*** (aplikimi nr. 2156/10) kishte të bënte me një ish-anëtar të shërbimeve sekrete të Holandës, i cili ishte akuzuar për nxjerrjen e sekreteve shtetërore. Parashtruesi i aplikimit, z. M, u ankua te Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut që procedurat penale të mëvonshme kishin qenë të padrejta. Në aktgjykimin e saj, Gjykata vendosi njëzëri që kishte pasur **shkelje të nenit 6 §§ 1 (e drejta për gjykim të drejtë) dhe 3 (c) (e drejta për t'u ndihmuar nga një mbrojtës i zgjedhur prej tij)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata gjeti se si pasojë e kërcënimit për ndjekje penale në rast se z. M do t'i shpaloste sekrete shtetërore avokatëve të tij, komunikimi midis tij dhe avokatit nuk ishte i lirë dhe i pakufizuar në aspektin e përmbajtjes, duke kompromentuar në këtë mënyrë në mënyrë të parikuperueshme drejtësinë e procedurave kundër tij. Megjithatë, më tej, Gjykata vendosi njëzëri që **nuk kishte pasur shkelje të nenit 6 §§ 1 (e drejta për gjykim të drejtë) dhe 3 (b) dhe (d) (e drejta për kohë dhe lehtësi të përshtatshme për përgatitjen e mbrojtjes dhe e drejta e thirrjes dhe marrjes në pyetje të dëshmitarëve)** të Konventës. Në veçanti, refuzimi i anëtarëve të shërbimeve sekrete për t'u përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga mbrojtja për shkak të detyrimit të tyre për ruajtjen e sekretit nuk binte ndesh me nenin 6 §§ 1 dhe 3 (d). Parashtruesi i aplikimit shpjegoi se strategjia e tij kishte qenë të demonstronte se dikush tjetër do të mund të kishte nxjerrë informacione të klasifikuara dhe se kjo linjë mbrojtjeje ishte kompromentuar meqenëse ai nuk mund t'i pyeste si duhej dëshmitarët nga shërbimet sekrete. Gjykata vuri re se në teori, kjo ishte një strategji mbrojtjeje plotësisht legjitime. Megjithatë, duke marrë parasysh vëllimin e madh të provave që e lidhnin atë me krimin, ai nuk kishte pasur të drejtë të bënte kërkesa të çuditshme me shpresën se mund të shfaqej ndonjë shpjegim alternativ. Gjykata vuri re se një proces i ri gjyqësor apo rihapja e procedurave në vend me kërkesën e parashtruesit të aplikimit paraqet një mënyrë të përshtatshme për të korrigjuar shkeljen.

* Monitorimi i komunikimeve elektronike të një punonjësi rezultoi në shkeljen e së drejtës së tij të jetës private dhe të korrespondencës (05/09/2017)

Rasti ***Bărbulescu kundër Rumanisë*** (aplikimi nr. 61496/08) kishte të bënte me vendimin e një kompanie private për të shkarkuar një punonjës pas monitorimit të komunikimit të tij elektronik dhe pas qasjes në përmbajtjen e tyre dhe me pretendimin se gjykatat e vendit kishin dështuar në mbrojtjen e tëdrejtës së tij të jetës private dhe korrespondencës. Në aktgjykimin e Dhomës së Madhe për këtë rast, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi, me

11 vota pro dhe 6 kundër, **se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet kombëtare nuk ia kishin mbrojtur si duhet të drejtën e z. Bărbulescu për respektimin e të drejtës së tij private dhe të korrespondencës. Pas kësaj, ato nuk kishin arritur të vinin një ekuilibër të drejtë midis interesave që rrezikoheshin. Në veçanti, gjykatat kombëtare kishin dështuar në përcaktimin e asaj nëse z. Bărbulescu i ishte dhënë një njoftim paraprak nga punëdhënësi i tij lidhur me mundësinë e monitorimit të komunikimeve të tij; ato nuk kishin marrë parasysh as faktin se ai nuk ishte informuar për natyrën dhe shkallën e monitorimit, apo shkallën e futjes në jetën e tij private dhe në korrespondencën e tij. Krahas kësaj, gjykatat kombëtare kishin dështuar në përcaktimin, së pari, të shkaqeve specifike që justifikojnë aplikimin e masave të monitorimit; së dyti, të asaj nëse punëdhënësi mund të kishte përdorur masa që paraqesin më pak hyrje në jetën private dhe korrespondencën e z. Bărbulescu; dhe, së treti, të asaj nëse punëdhënësi mund t'i qasej komunikimeve pa e vënë atë në dijeni.

*** Urdhërimi i gazetares për të dhënë prova lidhur me një burim nuk ishte i arsyetuar, edhe pse vetë burimi ishte i njohur për policinë (05/10/2017)**

Rasti ***Becker kundër Norvegjisë*** (aplikimi nr. 21272/12) kishte të bënte me një gazetare, Cecilie Becker, për një gazetë të përditshme, e cila ishte urdhëruar të jepte prova në një rast penal të hapur kundër njërit prej burimeve të saj, z. X, për manipulim tregu. Z. X i kishte konfirmuar policisë se kishte qenë burimi i znj. Becker për një artikull që ajo kishte shkruar në vitin 2007 lidhur me gjendjen gjoja të vështirë ekonomike të Kompanisë Norvegjeze të Naftës. Pas këtij artikulli, stoku i kompanisë u ul. Z. X më pas u akuzua se kishte përdorur znj. Becker për të manipuluar tregun financiar. Z. Becker refuzoi në çdo fazë të procedurave të dëshmonte kundër z. X, prandaj gjykatat e urdhëruan atë të dëshmonte lidhur me kontaktet që kishte pasur me të, duke gjetur se nuk kishte asnjë burim që ajo do të mbronte, meqenëse ai ishte dorëzuar vetë. Ata morën parasysh edhe se provat e saj mund të ndihmonin mjaftueshëm gjykatat në zbardhjen e së vërtetës së rastit. Megjithatë, z. X u dënua për akuzën që i ishte ngarkuar, përpara se të merrej vendimi i plotfuqishëm lidhur me detyrën e saj për të ofruar prova. Në aktgjykimin e saj në këtë rast, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut arriti njëzëri në përfundimin se: **ishte shkelur neni 10 (liria e shprehjes)** i KEDNJ-së. Gjykata gjeti se vlerësimi i saj u kthye, midis të tjerash, në drejtim të asaj nëse provat e znj. Becker ishin nevojitur gjatë hetimit penal dhe procedurave gjyqësore të mëvonshme, të kryera kundër burimit të saj. Gjykata vuri në dukje se refuzimi i saj për të shpalosur burimin (apo burimet) e saj nuk kishte penguar në asnjë kohë as hetimet dhe as procedurat kundër z. X. Në të vërtetë, gjykata e shkallës së parë, e cila dënoi z. X, ishte informuar nga prokurori se nuk ishte parashtruar asnjë kërkesë për zgjatje afati (në pritje të vendimit të plotfuqishëm lidhur me detyrimin për të dhënë prova), sepse rasti ishte shpalosur në mënyrë të mjaftueshme edhe pa deklaratën e z. Becker. Gjithashtu, Gjykata mbajti parasysh se metodat e gazetarisë të ndjekura nga znj. Becker nuk ishin vënë kurrë në pikëpyetje dhe se ajo nuk ishte akuzuar për kurrfarë aktiviteti të kundërligjshëm. Për më tepër, e drejta e saj si gazetare për t'i mbajtur konfidenciale burimet e saj nuk mund të hiqej në mënyrë automatike për shkak të sjelljes së personit burimor të saj apo sepse identiteti i burimit të saj ishte bërë i ditur. Për këtë arsye, Gjykata nuk u bind se rrethanat në rastin aktual apo shkaqet e dhëna kishin justifikuar detyrimin e znj. Becker për të dëshmuar.

*** Mbikëqyrja me kamera e sallave të leksioneve në Malin e Zi shkelte të drejtën e profesorëve për privatësi (28/11/2017)**

Në aktgjykimin në rastin ***Antović dhe Mirković kundër Malit të Zi*** (aplikimi nr. 70838/13) Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi, me 4 vota pro dhe 3 kundër, **se kishte pasur shkelje të nenit 8 (e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare)** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Rasti kishte të bënte me ankesën për pushtim të privatësisë, të paraqitur nga dy profesorë në Shkollën e Matematikës të Universitetit të Malit të Zi, Nevenka Antović dhe Jovan Mirković, pas instalimit të kamerave të mbikëqyrjes në zonat ku ata jepnin mësim. Ata pohuan se nuk kishin kontroll efikas mbi informacionin që mblidhej dhe se mbikëqyrja kishte qenë e paligjshme. Gjykatat e vendit e hodhën poshtë kërkesën për kompensim, megjithatë ato gjetën se çështja e jetës private nuk kishte qenë problem meqenëse auditorët ku znj. Antović dhe z. Mirković jepnin mësim ishin zona publike. Në fillim, Gjykata e hodhi poshtë argumentin e qeverisë se rasti ishte i papranueshëm, sepse nuk rrezikohej asnjë element privatësie, meqenëse zona që ishte nën mbikëqyrje ishte zonë publike dhe pune. Gjykata vuri re se kishte gjetur më përpara se "jeta private" mund të përfshijë aktivitetet profesionale dhe vlerësoi se kjo vlente edhe për rastin e z. Antović dhe z. Mirković. Për këtë arsye, aplikohej neni 8. Nisur nga meritat e rastit, Gjykata gjeti se mbikëqyrja me kamera kishte shkaktuar ndërhyrje në të drejtën e tyre për privatësi dhe se provat tregonin se mbikëqyrja kishte shkelur dispozitat e së drejtës së brendshme të vendit.
Në të vërtetë, gjykatat vendore nuk kishin marrë parasysh asnjë arsyetim ligjor për mbikëqyrjen, sepse kishin vendosur që në fillim se nuk kishte pasur shkelje të privatësisë.

*** Refuzimi i autoriteteve sllovene për dhënien e pensionit të moshës një ish-qytetari të Serbisë (05/12/2017)**

Rasti ***Ribać kundër Sllovenisë*** (nr. 57101/10) kishte të bënte me refuzimin e autoriteteve për t'i dhënë z. Aranđel Ribać, shtetas slloven, i cili kishte lindur në vitin 1942 dhe që jeton në Maribor (Slloveni), një pension moshe midis nëntorit të vitit 1998 dhe prillit të vitit 2003. Z. Ribać ishte qytetar i Serbisë në Republikën Socialiste Federale të Jugosllavisë (RSFJ), por kishte jetuar në Slloveni që prej vitit 1964. Deri në vitin 1991, kur doli në pension, ai kishte shërbyer si zyrtar në shërbimin aktiv ushtarak në Ushtrinë Popullore të Jugosllavisë. Në shkurt të vitit 1992, ai aplikoi për një paradhënie të pensionit të tij ushtarak në pajtim me urdhrin përkatës, që kishte hyrë në fuqi në vitin 1992 nga Republika e Sllovenisë, e cila ishte bërë e pavarur nga RSFJ-ja në vitin 1991. Me vendimin e majit të vitit 1993, autoritetet pensionale të Sllovenisë gjetën se ai kishte pasur të drejtë për të marrë këtë paradhënie duke filluar nga nëntori i vitit 1991. Në tetor të vitit 1998, autoritetet pensionale nxorën një vendim për të mos e konvertuar paradhënien e z. Ribać për pensionin e tij ushtarak në pension moshe, në pajtim me Aktin e të Drejtave që Dalin nga Sigurimi Pensional dhe në Rast Aftësie të Kufizuar të Ish-Personelit Ushtarak, të zbatuar në vitin 1998, për shkak se ai nuk përmbushte kushtet ligjore. Prandaj, paradhënia e tij u pezullua. Autoritetet e hodhën poshtë ankesën e tij në shtator të vitit 2002, duke pohuar se ai nuk mund të ishte përfitues meqenëse nuk kishte shtetësi sllovene dhe nuk kishte respektuar kërkesat që zbatohen për përfituesit e huaj. Më pas, ai mori qytetarinë sllovene dhe iu dha një pension moshe nga prilli i vitit 2003. Një kërkesë për shqyrtimin gjyqësor të vendimit të vitit 2002, që z. Ribać e kishte parashtruar ndërkohë, ishte hedhur poshtë nga gjykata e punës dhe sociale në janar të vitit 2006. Ankesat e tij u hodhën poshtë dhe në fund, Gjykata Kushtetuese vendosni, në mars të vitit 2010, që të mos e pranonte ankesën e tij kushtetuese për shqyrtim. Z. Ribać u ankua se refuzimi për t'i dhënë atij pensionin e moshës midis nëntorit të vitit 1998 dhe prillit të vitit 2003 për shkak se nuk kishte pasur shtetësi sllovene, kishte shkelur nenin 14 (ndalimi i diskriminimit) të lidhur me nenin 1 të protokollit nr. 1 (mbrojtja e pronës). Në aktgjykimin e saj në këtë rast, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut arriti njëzëri në përfundimin se: **kishte pasur shkelje të nenit 14 në lidhje me nenin 1 të Protokollit 1** të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe i dha parashtruesit të kërkesës, si kompensim të drejtë, shumat prej 37,000 eurosh (dëm material), 5,000 eurosh (dëm moral) dhe 3,570 (kosto dhe shpenzime).

*** Procedura e re për shkeljet përdoret për herë të parë në aktgjykimin e vitit 2014 kundër Azerbajxhanit, lidhur me politikanin e opozitës Mammadov (14/12/2017)**

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) duhet të shqyrtojë nëse Azerbajxhani ka refuzuar të respektojë aktvendimin e GJEDNJ-së në rastin e politikanit të burgosur të opozitës, Ilgar Mammadov. Kjo është hera e parë e përdorimit të procedurës së re për shkeljet. Procedura u përfshi në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut në vitin 2010 dhe i mundëson Komitetit të Ministrave, i cili, sipas Konventës, ka përgjegjësinë për mbikëqyrjen e ekzekutimit të aktgjykimeve të Gjykatës, që t'i drejtojë pyetje GJEDNJ-së lidhur me atë nëse një vend ka refuzuar të respektojë aktvendimin e plotfuqishëm. Më 5 dhjetor të vitit 2017, Komiteti vendosi të niste procedurat kundër Azerbajxhanit për shkak të refuzimit të vazhdueshëm të autoriteteve për të siguruar lirimin pa kushte të z. Mammadov pas gjetjes së GJEDNJ-së në vitin 2014 se kishte pasur disa shkelje të të drejtave të tij. GJEDNJ mori një kërkesë formale nga Komiteti më datë 11 dhjetor. Procedura do të paraqitet përpara Dhomës së Madhe të GJEDNJ-së. Z. Mammadov, i lindur në vitin 1970, ishte arrestuar dhe mbajtur në arrest në vitin 2013, pas protestave në qytetin e Ismayilli-t. Aktualisht, ai po vuan një dënim me burg prej 7 vitesh, pasi u dënua në vitin 2014 për çrregullime masash dhe dhunë kundër zyrtarëve publikë. GJEDNJ-ja gjeti në vitin 2014 se z. Mammadov ishte arrestuar dhe mbajtur në arrest pa asnjë provë mbi bazën e së cilës do të kishte dyshim të arsyeshëm se kishte kryer një vepër penale dhe arriti në përfundimin se qëllimi real i mbajtjes së tij në arrest ishte për t'ia mbyllur gojën ose për ta ndëshkuar për shkak të kritikave ndaj qeverisë. Gjykata gjeti se ishin shkelur neni 5 §§ 1 dhe 4 (e drejta e lirisë dhe sigurisë), neni 6 §§ 2 (e drejta për prezumimin e pafajësisë) dhe neni 18 (kufizimi i përdorimit të kufizimeve mbi të drejtat) të Konventës Evropiane. **Komiteti i Ministrave kishte nisur procedurat e shkeljes në bazë të paragrafit 4 të nenit 46 (forca detyruese dhe ekzekutimi i vendimeve) të Konventës. Ky nen i mundëson Komitetit t'i drejtojë GJEDNJ-së një pyetje lidhur me atë nëse një vend ka dështuar në respektimin e një aktgjykimi të GJEDNJ-së.** Në fillim, Komiteti duhet të dërgojë një njoftim zyrtar lidhur me vendin përkatës, gjë që e bëri në tetor, dhe më pas të miratojë një vendim referues me dy të tretat e votave. GJEDNJ do të marrë parasysh pyetjen si Dhomë e Madhe, formacioni i saj më i lartë gjyqësor. Komiteti i Ministrave dhe palët përkatëse do të kenë mundësi të parashtrojë komente me shkrim brenda afateve të përcaktuara nga Kryetari i Dhomës së Madhe. Dhoma e Madhe mund të vendosë edhe për mbajtjen e një seance dëgjimore. Nëse Dhoma e Madhe gjen se ka pasur shkelje për shkak se Azerbajxhani ka dështuar në respektimin e aktgjykimit të GJEDNJ-së të vitit 2014 në këtë rast, ajo do ta kthejë rastin te Komiteti i Ministrave për shqyrtimin e masave që duhet të ndërmerren. Edhe nëse nuk konstatohet asnjë shkelje, rasti do të kthehet sërish te Komiteti i Ministrave, i cili më pas do të mbyllë shqyrtimet e veta.

(*Për më shumë detaje vizitoni faqen e internetit të Gjykatës Evropiane për të Drejta të Njeriut: www.echr.coe.int*)

1. Konferenca për kompetencat kushtetuese në vendet portugalisht-folëse (KKKVPF)

Shkurt 2018

Bissau - Seminari i konferencës për kompetencat kushtetuese në vendet portugalisht-folëse (KKKVPF).

2. Seanca plenare e 114-të e Komisionit të Venecias të Këshillit të Evropës

16 – 17 mars 2018

Venecia - Scuola Grande di San Giovanni Evangelista.

3. Konferenca Botërore për Drejtësinë Kushtetuese

17 mars 2018

Venecie - Takimi i 13-të i Zyrës së Konferencës Botërore për Drejtësinë Kushtetuese.

4. Konferenca ndërkombëtare me rastin e 25-vjetorit të Gjykatës Kushtetuese të Sllovakisë

11 prill 2018

Koshicë - Gjykata Kushtetuese e Sllovakisë do të organizojë një konferencë ndërkombëtare me temë: "*Drejtësia Kushtetuese – Sfidat dhe Perspektivat*" me rastin e 25-vjetorit të saj.

5. Konferenca Iberiko-Amerikane për Drejtësinë Kushtetuese (KIADK)

Maj 2018

Panama – Konferenca XII Iberiko-Amerikane për Drejtësinë Kushtetuese.

6. Drejtësia Kushtetuese - Letoni

24 – 25 maj 2018

Rigë - Gjykata Kushtetuese e Letonisë do të organizojë konferencën ndërkombëtare me temë: "*Roli i Gjykatave Kushtetuese në Botën e Globalizuar të shekullit të 21-të*".

Aktgjykim

KO 55/17

Parashtrues

Tonka Berisha

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit KGJ nr. 13/2017, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të 13 janarit 2017

Në kërkesën e parashtruar më 28 prill 2017, parashtruesja e kërkesës, znj. Tonka Berisha, kontestoi vendimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), nr. 13/2017, të 13 janarit 2017, për zgjedhjen e Hasan Shalës për kryetar të Gjykatës së Apelit të Kosovës. Parashtruesja e kërkesës pretendoi se në garën për zgjedhjen e Kryetarit të ri të Gjykatës së Apelit, në të cilën edhe ajo ishte njëra ndër kandidatët, janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ).

I. Pas shpalljes së konkursit nga KGJK-ja për pozitën e Kryetarit të Gjykatës së Apelit, më 4 nëntor 2016, dhe intervistimit të tre kandidatëve më 19 dhjetor 2016, parashtruesja e kërkesës ishte renditur e para në listë, me 100 pikë të fituara përderisa kundërkandidati Hasan Shala ishte renditur i dyti, me 84 pikë të fituara. Më 13 janar 2017, ishte zhvilluar edhe raundi i parë i votimit nga anëtarët e Komisionit për Vlerësim dhe Intervistim të kandidatëve. Parashtruesja e kërkesës, e renditur e para në listë në bazë të pikëve të fituara, duke u bazuar në mesataren e pikëve të Komisionit ishte votuar e para, me 2 vota "për", 1 votë "kundër" dhe 6 "abstenim". Sipas KGJK-së, ajo nuk mori shumicën e nevojshme të votave, dhe procedura e votimit vazhdoi për kandidatin e dytë. Në raundin e dytë që u zhvillua të njëjtën ditë, kandidati Hasan Shala, i renditur si kandidati i dytë në listë, mori 7 vota "për", 1 votë "kundër" dhe 1 "abstenim". Si rrjedhojë, KGJK-ja zgjodhi z. Hasan Shala në pozitën e kryetarit të Gjykatës së Apelit të Kosovës. Parashtruesja në kërkesën e saj pretendoi se me procesin zgjedhor të zhvilluar nga KGJK-ja janë shkelur të drejtat e saj të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 32 [E Drejta për Mjete Juridike], nenin 45 [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes], nenin 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] dhe nenin 108.4 [Këshilli Gjyqësor i Kosovës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, parashtruesja e kërkesës pretendoi edhe shkelje të nenit 13 (E drejta për zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, të nenit 32 [E Drejta për Mjete Juridike] të Kushtetutës Kosovës në lidhje me nenin 13 (E drejta zgjidhje efektive) të KEDNJ-së, si dhe shkelje të nenit 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave] të Kushtetutës. Ndërkaq, lidhur me mosshterjen e mjeteve efektive juridike në rastin e saj, parashtruesja iu referua aktgjykimeve të Gjykatës në rastet: KI06/10, *Valon Bislimi kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe Ministrisë së Drejtësisë,* si dhe Aktgjykimit të Gjykatës në rastin nr. KI99/14 dhe KI100/14, vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve të Këshillit Prokurorial të Kosovës lidhur me procedurën e zgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit.

II. Pasi që e vlerësoi kërkesën të pranueshme dhe të dorëzuar në pajtim me afatin 4 (katër) mujor të përcaktuar me nenin 49 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese, Gjykata vërejti se dispozitat e Ligjit nr. 03/L-223 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nuk parashohin mjete juridike kundër vendimit të kontestuar nga parashtruesja e kërkesës. Sipas vlerësimit të Gjykatës, KGJK-ja nuk e ka mbështetur pohimin se në rastin konkret, parashtruesja e kërkesës ka mundur të iniciojë konflikt administrativ dhe të shfrytëzojë mjetet juridike në dispozicion të saj sipas Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, me praktikën gjyqësore përkatëse, ku do të shihej se parashtruesja do të kishte perspektivë të arsyeshme për sukses, në rast se ajo do të kishte zgjedhur të inicionte një konflikt administrativ. Gjykata më tutje vlerësoi se, "duke marrë parasysh specifikën e procedurës së zgjedhjeve për pozitën e Kryetarit të Gjykatës së Apelit dhe domosdoshmërinë që kjo të bëhet në kohën e duhur, Gjykata është e mendimit se nuk ka mjet juridik që adreson në mënyrë efektive pretendimet e ngritura nga parashtruesja e kërkesës". Gjykata po ashtu gjeti se, "rasti aktual ngre çështje të 'barazisë para ligjit' për të gjithë kandidatët e përfshirë në procesin e votimit për pozitën e Kryetarit të Gjykatës së Apelit, dhe me këtë implikim, Gjykata konsideron se mund të merret parasysh edhe neni 24.1 i Kushtetutës".

E kur është fjala për procesin zgjedhor, Gjykata rikujtoi se, "në procesin e votimit, aspekt themelor i parimit të 'barazisë' është që çdo kandidat do të përfitojë nga 'barazia e mundësive'. Kjo do të thotë që të gjithë kandidatët do të kenë mundësinë të shqyrtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë". Sipas Gjykatës, në procesin e votimit të zbatuar nga KGJK-ja, në fakt, nuk kishte zgjedhje midis alternativave, sepse secili kandidat u votua veçmas. Përveç kësaj, në çdo raund të votimit, secili prej personave që kanë votuar kishte pasur prapë mundësinë të votonte për ose kundër kandidatit që votohej. Në vijim, Gjykata vërejti se mënyra si është rregulluar dhe zhvilluar procesi i votimit ngre dyshime lidhur me sigurinë e tij juridike dhe administrimin e duhur të sistemit gjyqësor dhe formimit të tij. Në fund, Gjykata konsideroi se procesi i votimit i kryer nga KGJK-ja përbën padrejtësi në procedurën e votimit sepse është e pamundur të dihet se kush kishte në fakt mbështetjen e shumicës së anëtarëve që votuan dhe kush nuk e kishte, dhe konkludoi se KGJK-ja duhet të mbajë proces të ri të votimit.

INFORMATA PËR GJYKATËN

Ndërtesa e Gjykatës Kushtetuese:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, që nga funksionalizimi i saj më 2009, është e vendosur në ish-objektin e Trupave Mbrojtëse të Kosovës, që ndodhet në qendër të Prishtinës, në lagjen "Pejton". Ky lokacion i Gjykatës, në qendër të kryeqytetit, është simbol i qasjes së barabartë të të gjithë qytetarëve dhe të palëve të tjera të autorizuara në drejtësinë kushtetuese. Ky objekt ndër vite është përshtatur për nevojat dhe për natyrën e punës së Gjykatës Kushtetuese. Kjo është bërë me ndihmën e donatorëve, siç është ndërtimi i sallës së gjykimeve, që është financuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2010, themelimi i Bibliotekës së Gjykatës, e cila u mbështet në tërësi nga projekti i GIZ-it për Reformë Ligjore, si dhe sigurimi i zyrave shtesë (kontejnerë), donacion nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Turqisë në vitin 2011. Ky objekt ka gjithsej 784 m2 dhe shfrytëzohet nga 65 punonjës të Gjykatës.

ADRESA

Rruga: "Perandori Justinian", nr. 44, 10000, Prishtinë
Tel: +381 (0)38 60 61 62
Mob: +377 (0)45 200 595; +377 (0)45 200 576
Fax: +381 (0)38 60 61 70
E-mail: gjykata.kushtetuese@gjk-ks.org
Ueb: www.gjk-ks.org